

KOMUNA E VUSHTRRIË

NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE

ose

PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

☐ Punë

☐ Furnizim

☒ Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara]

Data e përgatitjes te këtij njoftimi: 05.05.2026

Nr i Prokurimit	644-26-3046-2-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA E VUSHTRRIË		
Adresa Postare: SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173		
Qyteti: VUSHTRRI	Kodi postar: 42000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Personi Përgjegjës Ilmi Azemi Personi Kontaktues Fisnik Qirezi		Telefoni: +383 20042403
Email: prokurimi.vushtrri@rks-gov.net ilmi.azemi@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		https://kk.rks-gov.net/Vushtrri

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve
II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i> Ka të bëjë me Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve nga objektet komunale dhe shkollore, qendra të mjeksisë familjare, shtëpi rezidenciale, ne objekte të Autoritetin kontraktues për më shumë referoju Aneksit 1 të specifikimeve teknike.
II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i> 90250000-4

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

III.1.1) Lloji i procedurës <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i>
☒ E hapur
☐ E kufizuar
☐ Konkurruese me negociata
☐ Kuotim i çmimit

III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:
--

NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE		
Përmirësim	☐	Informata shtesë
	☐	
Njoftim për kontrate	☒	Njoftim për dhënie kontrate
	☐	☐
IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET <i>(nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)</i>		
IV.2.1) Modifikimi i informatave origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues	☒	Publikimi në webfaqen e KRPP-së ☐ nuk është në përputhje me informatat origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues
		Të dyja ☐
IV.2.2) Në njoftimin origjinal	☐	Në dokumentet e tenderit ☐ Të dyja ☒
IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal <i>(nëse aplikohet)</i>		
Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:	Në vend të:	Është :

Në FTD pika 23.1 dhe në njoftimin për kontratë. Afati i fundit i dorëzimit të tenderëve/aplikacioneve	27.05.2026	28.05.2026
Afati i fundit i dorëzimit të tenderëve aplikacioneve	27.05.2026 14:00:00	28.05.2026 14:00:00
Informata të tjera shtesë:	Afati kohor për dorëzimin e tenderëve/aplikacioneve i paraparë për datën 27.05.2026 shtyhet për datën 28.05.2026 , meqenëse data 27.05.2026 është ditë feste.	
Kërkesat e përshtatshmërisë	Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65, Dëshmia 1. Lidhur me nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, të LPP-së me të cilën dëshmohet se tenderuesi i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë për të konkuruar. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik , duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dëshmia 2. Në lidhje me	

	Nenin 65, paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Komerciale) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës (Original apo kopje e Noteruar) Dëshmia 3. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Themelore e vendit të themeluesit të OP. Ek.) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose Kopje e Noteruar. Dëshmia 4. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik . Dëshmia Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të Njoftimit për
--	---

	Kontratë, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës (Kopje) Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla nga Operatori ekonomik i rekomanduar për shpërblim me kontratë, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.
Përshtatshmëria profesionale	Kërkesa 1. Operator Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të Themelimit. Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar, duhet të dorëzohet kopje. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar si deklarues i TVSH-së Dëshmia 2. Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje. Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se posedon leje per DDD të lëshuar nga ministria përkatëse. Kërkesë 4. OE duhet të jetë i certifikuar me ISO standard ,9001 2015 për shërbime cilësore të DDD-së; Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se posedon leje per importimin e produkteve Biocide të lëshuar nga ministria përkatëse, Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar, duhet të dorëzohet kopje. Dëshmia 2. Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje. Dëshmia 3. Lejen e punes të lëshuar nga ministria përkatëse e cila duhet te jete me validitet. Dëshmia 4. Kopjen e Çertifikates së standardeve ISO 9001 2015. Dëshmia 5. Lejen të lëshuar

	nga ministria përkatëse e cila duhet te jete me validitet
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	Operatori Ekonomik duhet te ofroj deshmi te kenaqshme AK-se per qarkullimi vjetor i OE gjate tri viteve te fundit (prej momentit te publikimit te njoftimit per kontrate) ne Vlere prej 40,000.00 €, OE duhet te deshmoj me qarkullime nga ATK-ja, banka apo ose kompani e audidimite lincencuar auditor i liecencuar per tri vitet e fundit se ka qarkullim 40,000.00 euro
Kapaciteti teknik dhe profesional	Kërkesa 1. OE duhet të dëshmojë se ka kryer projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDDsë, të realizuara përfunduar ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera totale e projekteve të realizuara jo me pak se 40,000.00€. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka të angazhuar nje (1) Veterinar ose Mjek Vetrinar të diplomuar ose apo Epedemiolog me së paku 5 (pese) vite përvojë të punës profesionale pas diplomimit, ne ciliesn e menaxherit te kontrates te caktohet me vendim i cili duhet te jete i certifikuar për Dezinfektim (DDD) si dhe së paku pese (5) punetore per kryerjen e sherbimeve ku 2 (dy) prej punetoreve duhet te jene te trajnuar certifikuar per kryerjen e sherbimeve te DDD-së. Kërkesa 3. Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së dezinsektimit hapësinor. Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se posedon listen emjeteve dhe paisjeve sipas Aneksit 7 te dosjes se tenderit, Dëshmia 1. Një listë

	të kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat e pranimit përfundimtar për kryerje me sukses të shërbimeve. Në rast se prezantohen referenca nga kompanitë private ose personat privat, të dëshmohet me transaksione bankare. Dëshmia 2. Të ofrohen diploma, kontrata e punës ose parakontratë-marrëveshje në emër të shërbimeve në fjalë, referencë, certifikatë per DDD dhe CV nga Veterineri, ndersa per stafin teknik punetoret, Kopje të Cerftifikatace për kryerjen e trajnimit për shërbimin DDD, dhe kontratat e puntorëve apo ose kontratat në vepër për shërbime të veqanta për DDD me emer titull dhe numer te prokurimit per kete aktivite te prokurimit Dëshmia 3. OE duhet të ofroj metodologjin e detajuar për implementimin e projektit. Deshmia 4. Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve me deshmite sipas kerkeses me larte. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.

----- (Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevoje) -----